Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën në organet e administratës shtetërore (,,Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11), si dhe në bazë të nenit 25 paragrafi 2 dhe paragrafi 5 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/17) Ministria e Arsimit dhe Shkencës caktoi Programin mësimor për ***Gjeografi*** për klasën VIII në arsimin fillor nëntëvjeçar.

# PROGRAMI MËSIMOR

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

# GJEOGRAFIA

Klasa VIII

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR

Shkup, Shkurt 2018

## HYRJE

Lënda mësimore që e studion sferën e shkencës gjeografike mësohet në periudhën e dytë zhvillimore në klasën e VI dhe periudhën e tretë: klasën e VII, VIII dhe IX në arsimin fillor nëntëvjeçarë.

Duke e përcjellur sistematikën shkencore, përkatësisht sistematikën profesionale si dhe teknologjinë shkencore, karaktersitikat e nxënësve dhe procesin mësimor, programet mësimore në gjeografi janë konceptuar ashtu që i zhvillojnë përmbajtjet nga më pak të ndërlikuara kah më të ndërlikuarat (thellësia dhe gjerësia e njohurive rritet me moshën e nxënësve).

Të mësuarit e gjeografisë si lëndë mësimore ka për qëllim t'ju ndihmojë nxënësve të arrijnë njohuri bazike për Tokën, rëndësinë dhe lidhshmërinë e elementeve natyrore dhe dukuritë shoqërore si dhe proceset në botën moderne, zhvillimi dhe kujdesi i mënyrës gjeografike të mendimit dhe zhvillimit të aftësive sociale efektive të nxënësit.

Programi mësimor në lëndën e gjeografisë ndërlidhet me programet mësimore të përvetësuara paraprakisht si: bota rreth nesh, natyra dhe shoqëria.

Lënda mësimore gjeografia mësohet si lëndë mësimore e detyrueshme me 2 orë font në javë (72 orë në vit) në klasën e VI, VII, VIII dhe IX.

Mësimi i gjeografisë duhet të realizohet sipas parimeve vijuese:

- mësimnxënia e orientuar ndaj mësimit të nxënësit;
- mësimi i pavarur dhe hulumtimi për secilin nxënës dhe përmes mësimit të përbashkët në grup;
- respektimi i parimeve të mësimit aktiv;
- përcjellja e vazhdueshme e përparimit të secilit nxënës nga mësimdhënësi dhe dhënia e informatave të rregullta për përparimin;
- vetëvlerësimi i përparimit personal të secilit nxënës.

## 2. QËLLIMET E MËSIMIT NË KLASËN E VIII

**Nxënësi /nxënësja:**

- Të aftësohet t'i njeh ligjet dhe nocionet themelore gjeografike universale;
- Ta kuptojë lidhshmërinë e gjeografisë me disciplinat natyrore dhe shoqërore mësimore – shkencore;
- Të arrijë, paraqet dhe të përvetësoj njohuri për objektet, dukuritë dhe proceset përmes shembujve konkret;
- Të vendoset në terminologjinë adekuate profesionale nga sfera e gjeografisë me të kuptuarit e rëndësisë;
- Ta kuptojë dhe zbatojë distancën, teknikat dhe instrumentet e orientimit të hartave fizike dhe ekonomike;
- Të zbulojë dhe paraqes fakte për burimet, format, gjendjet dhe ndryshimet në hapësirat gjeografike;
- Ti analizojë dhe ndërlidh faktorët natyror dhe shoqëror si elemente për zhvillimin e hapësirës gjeografike;
- Të paraqet të dhënat numerike në llojin e tabelës, dijagrameve, skicave dhe të dijë ti interpretojë në mësim;
- Të njihet me pozitën gjeografike në Kontinentin të Evropës në tokë;
- Të dijë ti përshkruajë vijat kufitare dhe ndarja bregdetare e kontinentit;
- Të njihet me karakteristikat e relievit në Evropë;
- Të arrijë njohuri themelore për klimën dhe hidrografinë e kontinentit;
- Të arrijë njohuri bazike për shtrirjen e botës bimore dhe shtazore në Evropë;
- Të njihet për ndarjen rajonale të Evropës;
- Të njihet me karakteristikat demografike të popullatës së kontinentit;
- Të dijë ti locojë kryeqytetet dhe qytetet më të mëdha në Evropë;
- Të njihet me problemet e ndotjes dhe mbrojtjen e mjedisin jetësor në shtetet e Evropës.

## 3. QËLLIMET KONKRETE

| TEMA I: KARAKTERISTIKAT NATYRORE – GJEOGRAFIKE TË EVROPËS - 15 orë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Qëllimet** | **Përmbajtjet** | **Nocionet** | **Aktivitetet dhe metodat** | **Rezultatet nga mësimnxënia** |
| **Nxënësi/nxënësja:**<br>- të njihet me karaktersitikat e përgjithshme gjeografike të Evropës;<br>– të njihet me vend pozitën e Evropës, kufijtë e saj dhe madhësinë;<br>– t'i përshkruajë kufijt natyror në Evropë;<br>– ta përshkruajë vijën bregdetare të Evropës;<br>– t'i njeh gadishujt dhe ishujt e Evropës;<br>– të njihet me detet të cilët e rrethojnë kontinentin;<br>– t'i paraqesë në hartë ngushticat dhe kanalet më të mëdha;<br>– t'i përshkruajë karaktersitikat e | -Pozita gjeografike, kufijt dhe madhësia e Evropës<br><br>- Përthyerja bregdetare e Evropës | Evropa<br>Kontinenti<br>Pozita gjeografike<br>Kufijt dhe vija kufitare natyrore<br><br>Vija bregdetare<br>Gjiret dhe Ngushticat<br>Fjordove<br><br>Masivet malore | – Përdorimi i hartës fizike të Evropës dhe botës për përshkrimin e vijës kufitare.<br>– Sqarimi në hartë i vendpozitës së Evropës në botë, karaktersitikat gjeografike dhe relievi.<br><br>– Përshkrimi i karaktersitikave të vijës bregdetare të Evropës.<br>– Përdorimi i Google Earth për shqyrtimin visual të përthyerjes së vijës bregdetare të kontinentit. | – Jep vështrimin e kufijve dhe pozitën gjeografike të Evropës në botë,<br>– Në hartën e Evropës e tregon kufirin ndërmjet Evropës dhe Azisë;<br>– definon dhe sqaron për kufizimin bregdetar të Evropës;<br>– identifikon se në cilët pjesë të Evropës mbizotëron relievi malor;<br>– jep një vështrim për malet e reja vargore dhe malet e vjetra gramade;<br>– në hartën e Evropës i tregon ultësirat dhe fushgropat më të mëdha;<br>- i dallon faktorët klimatik dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| relievit të Evropës dhe të ketë njohuri për pjesët më të mëdha të relievit;<br>– të fitojë njohuri për kushtet klimatike të Evropës;<br>– t'i dallojë hapësirat me kushte të caktuara klimatike;<br>– të arijë njohuri për vegjetacionin në Evropë;<br>– të dallojë dhe kategorizojë faktorët klimatik dhe zonat klimatike vegjetative në Evropë;<br>- t'i paraqes në hartë lumejt dhe pellgejt e lumejve në Evropë;<br>– t'i gjejë liqenet më të mëdha dhe ta sqarojë rëndësinë e tyre në Evropë. | - Karaktersitikat e relievit në Evropë<br>-Ndikimi i faktorëve klimatik mbi klimën në Evropë<br>-Zonat klimatike të vegjetacionit në zonën mesatare në Evropë<br>-Zonat klimatike të vegjetacionit në brezin e ngrohtë të ftohtësisë në Evropë<br>-Pellgjet e lumenjve dhe lumejt në Evropë | Ultësira<br>Fushgropa<br>Dinet<br>Plato<br>Prevalet<br>Llojet e klimës<br>Stepet<br>Tajga<br>Tundra<br>Hidrografia<br>Resoret ujore | – Përpunimi i pasqyrave tematike nga tekstet e grumbulluara për karaktersitikat gjeografike të Evropës.<br>– Sqarimi me ndihmën e hartës gjeografike të shtrirjes dhe karaktersitikave të zonave klimatike – vegjetative në Evropë.<br>– Përpilimi i hartës klimatike – vegjetative të Evropë.<br>– Përdorimi i hartës gjeografike për përshkrimin e hidrografisë së Evropës.<br>– Përdorimi i Google Earth për njohjen visuale të | zonat klimatike – vegjetacionit;<br>- jep sqarim për llojet klimatike në Evropë;<br>- i gjen objektet më të rëndësishme hidrografike në Evropë;<br>- i/e aftësuarpër arritjen e njohurive të reja për kontinentin;<br>- i/ e aftësuar për shqyrtimin vizuel të hartave të ndryshme përmes Google Earth. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | -Lumenjtë në Evropë | | hidrografisë së Evropës.<br>– Prezantimi TIK. | |

| TEMA II: KARAKTERSITIKAT SOCIO – GJEOGRAFIKE DHE NDARJA RAJONALE E EVROPËS - 9 orë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Qëllimet** | **Përmbajtjet** | **Nocionet** | **Aktivitetet dhe metodat** | **Rezultatet nga mësimnxënia** |
| **Nxënësi/ nxënësja:**<br>– t'i njeh karaktersitikat themelore të Evropës (numrin e popullsisë. Dendësinë e popullsisë, rritjen natyrore, grupin e racave dhe popujve);<br>– t'i njeh dhe vërej dallimet e popujve sipas përkatësisë së tyre fetare dhe gjuhës;<br>– të njihet me kulturën e ndryshme, traditat dhe zakonet e popujve në pjesët e ndryshme të Evropës;<br>– t'i njeh qytetet më të mëdha të Evropës dhe dallimet ndërmjet fshatrave në Evropë;<br>– të njihet me ndarjen rajonale dhe territoriale të Evropës;<br>– t'i tregojë në hartën gjeografike rajonet, shtetet dhe qytetet e tyre kryesore;<br>– të njihet me llojet e rregullimit të shtetit në Evropë. | Karaktersitikat themelore të popullsisë në Evropë<br><br>-Përkatësia fetare dhe gjuhësore si dhe raca e popullsisë në Evropë<br><br>-Kultura, tradita dhe zakonet e popullsisë në Evropë<br><br>-Vendbanimet në Evropë | Popullsia<br>Dendësia e popullsisë<br>Rritja natyrore<br>Grupet e racave<br>Popujt<br>Grupet e gjuhëve<br>Përkatësia fetare<br>Zakonet<br>Tradita<br>Kultura<br><br>Rajoni<br>Shteti | – Mësimdhënësi i sqaron nocionet e përmbajtjeve.<br>– Jep udhëzime për analizën në hartë.<br>– Sqaron dhe demonstron në hartë për dendësinë e popullsisë, rritjen natyrore dhe grupin e racave dhe të popujve.<br>– Mësimdhënësi sqaron për dallimet gjuhësore dhe fetare.<br>– Klasifikon popuj sipas grupeve gjuhësore dhe përkatësisë fetare.<br>– Inicon bisedë.<br>– Sqaron për dallimet në kulturë, traditë dhe zakonet te popujt e ndryshëm.<br>– Nxit në hulumtim dhe shkëmbim të njohurive ndërmjet nxënësve për dallimet në zakone, kulturë dhe traditë sipas përkatësisë fetare.<br>– Hulumtimi TIK për lagjet evropiane.<br>– Grumbullimi i të dhënave dhe shqyrtimi i dallimeve ndërmjet fshtareve dhe | – Sqaron për karaktareistikat themelore të popullsisë në Evropë;<br>– I dallon popujt sipas përkatësisë fetare dhe gjuhësore;<br>– I sqaron kulturat e ndryshme, traditat dhe zakonet e popujve në pjesë të ndryshme të Evropës.<br>– I identifikon qytetet më të mëdha në Evropë dhe dallimet ndërmjet fshatrave të Evropës;<br>– E sqaron ndarjen rajonale dhe territoriale të Evropës;<br>– I tregon rajonet në hartën gjeografike,shtetet dhe kryeqytetet e tyre; |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | -Ndarja rajonale dhe politike territoriale e Evropës | Kryeqyteti<br>Republika<br>Mbretëria<br>Principatat | qyteteve në Evropë.<br>– Prezantimi dhe biseda.<br>– Sqaron nocione, demonstron në hartë për rajonet dhe tregon kufijtë në rajone.<br>– Thekson analiza me përdorimin e hartave tematike për gjetjen e shteteve, qytetet kryesore në rajon. | – Sqaron për llojet e rregullimit të shteteve në Evropë;<br>– Përdor enciklopedi, revista, Internet për hulumtim;<br>– Bën korrelacion me lëndë tjera mësimore (historinë, biologjin shkencat natyrore). |

| TEMA III: PASQYRA GJEOGRAFIKE E RAJONIT TË EVROPËS JUGORE - 19 orë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Qëllimet** | **Përmbajtjet** | **Nocionet** | **Aktivitetet dhe metodat** | **Rezultatet nga mësimnxënia** |
| **Nxënësi/nxënësja:**<br>– ta njeh pozitën gjeografike, kufijt dhe madhësinë e Evropës Jugore;<br>– ti dijë karaktersitikat natyrore – gjeografike të Evropës Jugore;<br>– ti njeh karaktersitikat socio – gjeografike të Evropës Jugore;<br>– t'i njeh shtetet e Gadishullit Ballkanik;<br>– ti identifikojë në hartë shtetet dhe kryeqytetet e tyre kryesore;<br>– t'i njeh karaktersitikat natyrore – gjeografike të shteteve të Gadishullit Ballkanik;<br>– t'i njeh karaktersitikat ekonomike dhe socio – gjeografike të shteteve të Gadishullit Ballkanik;<br>– t'i njeh karaktersitikat natyrore – gjeografike të shteteve të Gadishullit Apenin; | - Karaktersitikat gjeografike të Evropës Jugore<br><br>**Gadishulli Ballkanik**<br>– Bullgaria<br>– Greqia<br>– Sërbia<br>– Shqipëria dhe Kosova<br>– Kroacia dhe Sllovenia<br>– Mali i Zi dhe Bosnja Hercegovina<br><br>**Gadishulli Apenin**<br>- Italia, San Marino dhe Vatikani | -Vija bregdetare<br>-Gadishujt<br>-Ishujt<br>-Grupet e ishujve<br>- Maki<br>-Gadishulli<br><br>-Kufijt shtetëror<br>-Rregullimi shtetëror<br>-Rodopet<br>-Musalla<br>-Republika<br>-Liqeni i Shkodrës<br>-Religjioni | - Prezantimi i Evropës Jugore.<br>– Në hartën e Evropës i tregon shtetet dhe kryeqytetet në Evropën Jugore.<br>– Thekson për përdorimin e atlasit për analizën e rajonit dhe përcaktimi i karaktersitikave.<br>– Power point prezantimi.<br>– Sqarime për Gadishullin Ballkanik, përshkruan kufij, reliev, klimë.<br>– Demonstrimi në hartë<br>– Nxitja e të menduarit dhe analiza nga harta.<br>– Orienton në hulumtim.<br>– TIK.<br>– Prezantimi i shteteve.<br>– Sqarimi i përshkrimit për karaktersitikat.<br>– Demonstron në hartë.<br>– Jep udhëzime për analizën në hartë dhe krahasimin e shteteve.<br>– Jep detyrë për hulumtim nga Interneti – TIK. | - E dallon pozitën gjeografike të Evropës Jugore;<br>- I tregon në hartë shtetet dhe kryeqytetet e Evropës Jugore;<br>- I dallon karaktersitikat e përgjithshme gjeografike dhe ekonomike të Evropës Jugore;<br>- Përcakton pozitën gjeografike, kufijt dhe madhësinë e Gadishullit Ballkanik, shtetet dhe kryeqytetet;<br>- I dallon karakteristikat natyrore – gjeografike, socio – gjeografike për shtetet, kryeqytetet dhe rregullimin shtetëror;<br>- E sqaron pozitën |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| – t'i njeh karaktersitikat socio – gjeografike dhe ekonomike të Gadishullit Apenin;<br>– T'i njeh karakteristikat gjeografike – natyrore të Gadishullit Apenin;<br>– T'i njeh karakteristikat gjeografike – natyrore të Gadishullit Pirinej;<br>– T'i njeh karaktersitikat socio -gjeografike dhe ekonomike të shteteve të Gadishullit Pirinej;<br>– Ta gjen ndërlidhjen reciproke ndërmjet gjeografisë dhe mjedsit jetësor në Evropën Jugore. | **Gadishulli Pirinej**<br>-Spanja, Portugalia dhe Andora<br><br>-Rrezikimi, ndotja dhe mbrojtja nga mjedisi jetësor i Evropës Jugore | | | gjeografike, kufijt dhe madhësinë e shteteve të Gadishullit Ballkanik;<br>- Sqarimi, përshkrimi dhe dallimi I karaktersitikave dhe specifikave të shteteve nga Evropa Jugore;<br>- Identifikon objekte gjeografike;<br>- I definon specifikat e karaktersitikave natyrore – gjeografike të vendeve të Evropës Jugore;<br>- Të demonstrojë në hartë për vendet e Evropës Jugore;<br>- Hulumton nga Interneti – Tik për vendet e Evropës Jugore;<br>- I sqaron ngjashmëritë dhe dallimet e popullsisë në Evropën Jugore;<br>- Vëren dallime ndërmjet shteteve ; |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | - I përshkruan traditat, kulturën dhe zakonet në vendet e Evropës Jugore;<br>- I përshkruan karaktersitikat më të rëndësishme të ekonomisë dhe zhvillimin e turizmit në Evropën Jugore. |

| TEMA IV: PASQYRA GJEOGRAFIKE E RAJONIT TË EVROPËS PERËNDIMORE - 6 orë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Qëllimet** | **Përmbajtjet** | **Nocionet** | **Aktivitetet dhe metodat** | **Rezultatet nga mësimnxënia** |
| – Nxënësi/nxënësja:<br>- Ta njeh pozitën gjeografike të Evropës Perëndimore;<br>- T'i tregoj në hartë shtetet në Evropën Perëndimore;<br>- T'i përshkruaj karaktersitikat e shteteve në Evropën Perëndimore;<br>- T'i njeh karakteristikat themelore të popullsisë në shtetet e Evropës Perëndimore;<br>- Të njihet me karaktersitikat themelore të ekonomisë së shteteve në Evropën perëndimore. | **Evropa Perëndimore**<br><br>-Britania e Madhe dhe R. e Irlandës<br><br>- Franca<br>- Beneluksi (Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu) | – Kriptodepresioni<br>– Estuarët<br>– Nasipë<br>– Kanalet<br>– Platformat e naftës<br>– Pasuritë natyrore<br>– Destinacionet turistike | – Hulumtimi i ndikimit dhe roli i deteve në jetën e njerëzve.<br>– Hulumtimi ndikimit dhe roli i lumenjëve dhe liqeneve në jetën e njerëzve.<br>– Në hartën e Evropës i tregon shtetet dhe kryeqytetet në Evropën Perëndimore.<br>– Në hartën e Evropës i vendos shtetet e Evropës Perëndimore.<br>– Në hartën e Evropës i përfshin karaktersitikat e klimës, hidrografisë dhe vegjetacionit të shteteve në evropën Perëndimore. Hulumton për karaktersitikat e ekonomisë në Evropën Perëndimore. | E dallon pozitën gjeografike të Evropës Perëndimore;<br>I tregon në hartë shtetet dhe kryeqytetet e Evropës Perëndimore;<br>I dallon karakteristikat natyrore – gjeografike, socio – gjeografike për shtetet, kryeqytetet dhe rregullimin shtetëror;<br>- A dallon kontributin e zbulimeve të mëdha gjeografike mbi zhvillimin e shteteve në Evropën Perëndimore;<br>- i/ e aftë për arritjen e pavarur të njohurive të raja për shtetet në Evropën |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Perëndimore. |

| TEMA V: PASQYRA GJEOGRAFIKE E RAJONIT TË EVROPËS VERIORE - 5 orë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Qëllimet** | **Përmbajtjet** | **Nocionet** | **Aktivitetet dhe metodat** | **Rezultatet nga mësimnxënia** |
| **Nxënësi/nxënësja:**<br>– ta njeh pozitën gjeografike, kufijt dhe madhësinë e Evropës Veriore;<br>– t'i tregoj në hartë shtetet në Evropën Veriore;<br>– t'i dijë karaktersitikat e shteteve në Evropën Veriore;<br>– ti njeh karaktersitikat themelore të popullsisë në shtetet në Evropën Veriore;<br>– të njihet me karaktersitikat themelore të ekonomisë së shteteve në Evropën Veriore; | **Evropa Veriore**<br><br>Suedia<br><br>Norvegjia dhe Finlanda<br><br>-Danimarka dhe Islanda | – Gadishulli<br>– Monarkia<br>– Fjordet<br>– Akullnajet<br>– Gjuha, kultura<br>– Xeheroret<br>– Pyjet<br>– Gejzerët<br>– Potenciali hidroenergjetik<br>– Energjetika<br>– Irvasi | – Përdor dhe demonstron hartën e Evropës për shtetet dhe kryeqytetet në Evropën Veriore.<br>– Në hartën memece të Evropës i vendos shtetet e Evropës Veriore.<br>– Në hartën e Evropës i sqaron karakteristikat e klimës, hidrografisë dhe vegjetacionit të shteteve në Evropën Veriore.<br>– Hulumton për karaktersitikat e ekonomisë në Evropën Veriore.<br>– Jep shembuj për doket dhe traditën kulturore të popujve të Evropës Veriore.<br>– | E dallon pozitën gjeografike të Evropës Veriore;<br>I tregon në hartë shtetet dhe kryeqytetet e Evropës Veriore;<br>I dallon karaktersitikat e përgjithshme gjeografike dhe ekonomike të Evropës Veriore;<br>Përcakton pozitën gjeografike, kufijt dhe madhësinë e Gadishullit Ballkanik, shtetet dhe kryeqytetet;<br>I dallon karakteristikat natyrore – gjeografike, socio – gjeografike për shtetet, kryeqytetet dhe rregullimin shtetëror; |

| TEMA VI: PASQYRA GJEOGRAFIKE E RAJONIT TË EVROPËS QENDRORE - 10 orë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Qëllimet** | **Përmbajtjet** | **Nocionet** | **Aktivitetet dhe metodat** | **Rezultatet e mësimnxënies** |
| **Nxënësi/nxënësja:**<br>– Ta njeh pozitën gjeografike të Evropës Qendrore;<br>– T'i tregoj në hartë shtetet në Evropën Qendrore;<br>– T'i përshkruaj karaktersitikat e shteteve në Evropën Qendrore;<br>– T'i njeh karaktersitikat themelore të popullsisë në shtetet e Evropës Qendrore;<br>– Të njihet me karaktersitikat themelore të ekonomisë së shteteve në Evropën Qendrore. | **Evropa Qendrore**<br><br>-Gjermania<br><br>-Polonia<br><br>- Çekia dhe Sllovakia<br><br>-Zvicra dhe Austria<br><br>-Hungaria<br><br>-Rumania | – Shteti<br>– Republika<br>– Monarkia<br>– Alpet<br>– Klima e Alpeve<br>– Klima kontinentale<br>– Rrjeti lumor<br>– Rrjeti i kanalit | – Përdor dhe demonstron hartën e Evropës për shtetet dhe kryeqytetet në Evropën Qendrore;<br>– Në hartën memece të Evropës i vendos shtete e Evropës Qendrore.<br>– Në hartën fizike të Evropës I vëren karaktersitikat e klimës, hidrografisë dhe vegejtacionit të shteteve në Evropën Qendrore.<br>– Hulumton për karakteristikat e ekonomisë në Evropën Qendrore.<br>– Jep shembuj për traditat dhe traditën kulturore të popujve të Evropës Qendrore.<br>– Thekson në përdorimin e atllasëve të rajonit dhe përcaktimin e karaktersitikave të shteteve.<br>– TIK prezantimi. | – E njeh pozitën gjeografike të Evropës Qendrore;<br>– E sqaron relieving dhe ti dallojë faktorët klimatik dhe yonat kliamtike – vegjetative;<br>– I gjen objektet më të rëndësishme hidrografike;<br>– Në hartë I tregon objektet më të rëndësishme hidrografike;<br>– Në hartë I tregon shtetet dhe kryeqytetet në Evropën Qendrore;<br>– I dallon karaktersitikat e përgjithshme natyrore – gjeografike, socio – gjeografike dhe ekonomike;<br>– I sqaron karaktersitikat socio – gjeografike dhe ekonomike të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | shteteve, kryeqyteteve dhe rregullimin shtetëror;<br>– i/e aftë për arritjen e pavarur të njohurive të reja për shtetet në Evropën Qendrore;<br>– e krahason zhvillimin ekonomik të rajonit të Evropës Qendrore me rajonet tjera të Evropës. |

| TEMA VII: PASQYRA GJEOGRAFIKE E RAJONIT TË EVROPËS LINDORE - 8 orë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Qëllimet** | **Përmbajtjet** | **Nocionet** | **Aktivitetet dhe metodat** | **Rezultatet e mësimnxënies** |
| **Nxënësi/nxënësja:**<br>– Ta njeh pozitën gjeografike të Evropës Lindore;<br>– Të njihet me ndarjen territoriale politike të Evropës Lindore;<br>– T'i paraqes në hartë shtetet në Evropën Lindore;<br>– T'i paraqet dhe përshkruaj kufijt e shteteve;<br>– T'i përshkruaj karaktersistikat natyrore të shteteve në Evropën Lindore;<br>– Të njihet me karaktersitikat themelore të popullsisë në shtetet e Evropës Lindore;<br>– Të njihet me karaktersitikat themelore të ekonomisë së shteteve në Evropën Lindore. | **Evropa Lindore**<br><br>-Rusia<br><br>-Ukraina<br><br>- Bjelorusia dhe Moldavia<br><br>-Letonia, Estonia dhe Lituania | – Klima kontinentale<br>– Klima polare<br>– Klima subpolare<br>– Makia<br>– Shelg polar<br>– Mështekra polare<br>-Krahinë me shtypje të ulët atmosferike<br>– Dhelpra polare | – Në hartën e Evropës i tregon shtetet dhe kryeqytetet e Evropës Lindore.<br>– Në hartën e Evropës i përfshin shtetet në Evropën Lindore.<br>– Në hartën e Evropës i përfshin karaktersitikat e klimës, hidrografisë dhe vegjetacionit të shteteve në Evropën Lindore. Hulumton për karaktersitikat e ekonomisë në Evropën Lindore.Jep shembuj për zakonet dhe traditën kulturore në Evropën Lindore.<br>– Thekson përdorimin e atlasit për analizë të rajonit dhe përcaktimin e karaktersitikave të shteteve.<br>– TIK prezantimi | – E njeh pozitën gjeografike të Evropës Qendrore;<br>– E sqaron relievin dhe ti dallojë faktorët klimatik dhe yonat kliamtike – vegjetative;<br>– I gjen objektet më të rëndësishme hidrografike;<br>– Në hartë i tregon objektet më të rëndësishme hidrografike;<br>– Në hartë i tregon shtetet dhe kryeqytetet në Evropën Qendrore;<br>– I dallon karaktersitikat e përgjithshme natyrore – gjeografike, socio – gjeografike dhe ekonomike;<br>– i sqaron karaktersitikat socio – gjeografike dhe ekonomike të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | shteteve, kryeqyteteve dhe rregullimin shtetëror;<br>– i/e aftë për arritjen e pavarur të njohurive të reja për shtetet në Evropën Qendrore;<br>– e krahason zhvillimin ekonomik të rajonit të Evropës Qendrore me rajonet tjera të Evropës. |

## 4. REKOMANDIMET DIDAKTIKE

Në programin mësimor është dhënë planifikimi orientues në orët mësimore për realizimin e temave dhe tërësive mësimore. Megjithatë, kuadri mësimor duhet në mënyrë të pavarur ta planifikojë fondin e orëve për realizimin e tërësishëm dhe të suksesshëm të qëllimeve të parashtruara nga programi. Duke e pasur parasyshë përbërjen e nxënësve në paralelet është heterogjen, mësimdhënësi duhet të praktikojë qasje diferencuese dhe individuale në kuadër të realizimit të mësimit. Një qasje e tillë është në funksion të nevojave specifike individuale të secilit nxënës dhe zhvillimi i potencialit dhe të arriturave individuale.

Rekomandohet përdorimi i këtyre mjeteve vijuese:

- libër i zgjedhur në nivel të shkollës për lëndën përkatëse, lejuar nga ministri;
- burimet tjera të mësimit në mjedisin e drejtpërdrejtë – objekte dhe dukuritë në natyrë;
- atlas, enciklopedi etj;
- Interneti, softueri arsimor:
- revistë;
- mjetet audio- vizuale.

Teknologjia didaktike bashkëkohore në mësimin e gjeografisë përveç përdorimit të hartave të ndryshme gjeografike, jep mundësi të veçanta për përdorimin e kompjuterit, përkatësisht zbatimin e gjerë të gjeoinformatikës në mësimin e gjeografisë. Gjithashtu, në mësim mund të përdoren dhe hartat memece, fletore e punës, libër leximi gjeografik, doracak për gjeografi, prospekte të ndryshme etj. Nocionet e përvetësuara të reja do të paraqesin sendërtim dhe zgjerim të nocioneve të arritura. Interpretimi i përshkrimeve nga nxënësit është e domosdoshme të jenë të nxitura nga mësimdhënësi në mënyrë I cili përshtatet në karaktersitikat individuale të nxënësit. Të shprehurit mund të jetë përmes: të folurit, esesë, metodave ilustruese, të përpunuara në skema, grafikone etj. Përdorimi i emrave dhe të dhënave në shifër duhet të jetë e paraqitur në nivelin e kuptueshëm. Integrimi i gjeografisë me lëndët tjera mësimore do të realizohet në të gjithë situatat në të cilat është prezent lidhshmëria më e madhe e përmbajtjeve.

### 5. VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

Gjatë mësimit rregullisht ndiqen dhe vlerësohen të arriturat e nxënësve, mblidhen treguesit për aktivitetet e tyre, motivimi për mësim, bashkëpunimi me të tjerët etj. (vlerësimi formativ). Gjithashtu, regullisht bëhet informimi i secilit nxënës, si dhe i prindërve për përparimin e nxënësit. Kjo komponentë është pjesë përbërëse e planifikimit të mësimit për mësimin dhe mësimnxënien. Rekomandohet të përdoren mënyrat vijuese të përcjelljes, kontrollimi dhe vlerësimi i të arriturave të nxënësve në kuadër të temave mësimore:

- gojarisht;
- me shkrim;
- praktikë (përpjekje, ushtrime etj.);
- pjesëmarrje në hulumtim dhe prezantim.

Nxënësit vlerësohen me nota numerike.

## 7. KUSHTET HAPËSINORE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Programi sa i përket kushteve hapësinore bazohet në Normativin për hapësirë, pajisje dhe mjetet mësimore për arsimin fillor nëntëvjeçar përcaktuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës me Vendim nr. 07--1830/1 prej 28.02.2008.

## 8. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

Mësimin në lëndën e gjeografisë për klasën VIII (e tetë) mund ta realizojë personi i cili ka mbaruar:

- studime nga gjeografia, drejtimi mësimor, VII/1 ose 240 SETK;
- AP ose SHLP, grupi histori dhe gjeografi (për mësimdhënës të cilët realizojnë mësim në shkollat fillore ndërsa kanë marrëdhënie pune për periudhë të pacaktuar).

## 9. FILLIMI I REALIZIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR

Data e fillimit: **01.09.2018 .**

## 10. NËNSHKRIMI DHE DATA E PËRCAKTIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR

Programi mësimor për ***gjeografi*** për klasën VIII në arsimin fillor nëntëvjeçar, me propozim të Byrosë së zhvillimit të arsimit, e përcaktoi ministri i Arsimit dhe Shkencës

**MINISTËR**

______________________________

**Prof. dr. RENATA DESKOSKA**

Përpiloi: grupi i punës, me vendim nr.02-123/1 prej 21.12.2017
Kontrolloi: Ivica Gievski, udhëheqës njësie
Lejoi: mr.Mitko Çeshllarov, udhëheqës sektori